

8.1 REGJISTRIMI EKZISTON NË BAZËN LOKALE TË TË DHËNAVE

Nëse regjistrimi për burimin bibliografik ekziston në bazën lokale të të dhënave, veprohet sipas procedurës së përshkruar në vazhdim.

Procedura

Dritarja **Regjistrimi bibliografik**.

1. Përzgjidhni metodën **Kërkimi / <akronimi i bazës lokale të të dhënave >/COBIB**.

Hapet dritarja **Kërkimi – Regjistrimi bibliografik (<akronimi i bazës lokale të të dhënave>)**.

2. Shënoni pyetjen e duhur për kërkim dhe ekzekutojeni kërkimin në bazën lokale të të dhënave. Procedura e kërkimit është e përshkruar gjërësisht në kap. 4.

Regjistrimi për burimin bibliografik ndodhet mes rezultateve të kërkimit.

3. Verifikojeni, nëse regjistrimi në bazën lokale të të dhënave është i saktë dhe i plotë.

Nëse regjistrimi është i duhuri, procedura e përpunimit bibliografik është kompletuar.

Nëse regjistrimi duhet të përmirësohet ose të plotësohet, vazhdon procedura përkatëse në kap. 8.4.

Nëse ky është regjistrim lokal, vazhdoni me një nga procedurat në kap. 8.6.